



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0776

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE NARA BIOTICS SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material stomatologjik” me numër të prokurimit 632-23-8446-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS, më 22/12/2023, mori këtë:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e NARA BIOTICS SH.P.K. me nr. 2023/0776, e datës 09/10/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material stomatologjik”, me numër të prokurimit 632-23-8446-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS ndërsa mbetet në fuqi vendimi i AK i dates 27.09.2023.

2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 09.08.2023, KOMUNA E GJAKOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material stomatologjik” me numër të prokurimit 632-23-8446-1-2-1. Ndërsa me datën 27.09.2023 AK ka

publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë PRO MEDICAL SH.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 30,00.00 €.

Me 29.09.2023, OE NARA BIOTICS SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 04.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe ka vërtetuar Njoftimin mbi vendimin e AK e datës 27.09.2023 me arsyetimin se OE ankues nuk ka ofruar transakcionin bankar siç është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues si dhe kontratat e prezentuara nuk mund të merren për bazë sepse në të gjitha kontratat thuhet “*kjo referencë është e vlefshme nga dt.15.08.2021 deri me 30.04.2023*” ndërsa te neni 4 thuhet “*kjo kontratë hynë në fuqi me dt.02.05.2023*” që i bie të jetë datë pas lëshimit të referencës.

Me 09.10.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE NARA BIOTICS SH.P.K., me nr. 776/23 lidhur me aktivitetin “Furnizim me material stomatologjik” me numër të prokurimit 632-23-8446-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues NARA BIOTICS SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Ankuesi pretendon se: “AK pa të drejtë e ka eliminuar nga procedura në fjalë pasi që nuk qëndrojnë arsyet e eliminimit sepse me datën 07.09.2023 është bërë hapja e tenderit,

transaksionet bankare janë të ngarkuara në aplikimin e tenderit 02.Dokumentet e NaraBiotics.pdf, në faqen e 16-të i gjeni edhe transaksionet bankare. Të bashkangjitur i gjeni dëshmitë se të gjitha këto dokumente janë të ngarkuara në sistem. Ndërsa në faqen 17 deri 24 i gjeni të gjitha deklaratimet e ATK-së. Si është e mundur që zyrtaret e prokurimit i shohin vetëm deklaratimet e ATK dhe të mos i shohin një faqe me lart të bashkangjitur edhe transaksionet bankare. Si dhe sa i përket kontratave gjitha janë me kompanitë private, andaj fillimisht duhet bërë furnizimin pastaj duhet nënshkruar kontrata. Të gjitha vlerat e Referencave janë nga furnizimet e datës 18.05.2021 deri më 30.04.2023 që do të thotë se janë brenda periudhës. Për ti vërtetuar të gjitha vlerat e Referencave i kemi bashkangjitur si dëshmi tek AK Komuna Gjakovës, Librat e shitjes të deklaruara në ATK.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6 dhe 7 të LPP – së.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 13/10/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 776/23, ndërsa me datë 27/10/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0776 me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.”*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit, ndërsa OE nuk është pajtuar me rekomandimin e ekspertit duke theksuar *“Të gjitha kompanitë private bashkëpunuese me ne bëjnë pagesa ndërmjet bankës dhe cash, QË DO TË THOTË JO TË GJITHA PAGESAT KRYHEN PËRMES BANKES. Për ti vërtetuar te gjitha vlerat e Referencave ne kemi bashkangjitur si dëshmi tek AK KK Gjakovës Librat e shitjes të deklaruara në ATK për të gjitha Referencat. Të gjitha kontratat janë nga Kompanitë private. Pra, asnjëra nga këto kontrata nuk janë publike dhe furnizimet nuk bëhen duke nënshkruar së pari kontratat, por duke bërë fillimisht furnizimin sipas kërkesës së Depove farmaceutike, Barnatoreve, Ordinancave Stomatologjike etj. Të gjitha vlerat e referencave janë nga furnizimet e datës 15.08.2021 deri 30.04.2023, që do të thotë se Brenda kësaj periudhe ne i kemi marr të gjitha vlerat e Referencave-Kontratave dhe me marrëveshje të dyanshme me datën 02.05.2023 janë bërë nënshkrimet e Referencave.”*

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE NARA BIOTICS SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0776 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar dhe sqarimeve shpesh eksperti verën që dokumenti i paraqitur si kontratë nga ana e kompanisë ankuese NARA Biotics dhe MATKOS Fharm ka shumë paqartësi ku në titull shkruhet që është kontratë pastaj brenda në tekst shkruan që është Referencë e vlefshme nga 15.08.2021 deri me 30.04.2023 dhe me tutje një paragraf ku shkruan që kjo kontratë hyn në fuqi me datë 02.05.2023. Pra është e pa qartë edhe për ekspertin se a është kjo kontratë për furnizim apo referencë. Ne pretendimin ankimor tjetër për të cilën është eliminuar OE ankues është se ai nuk i ka dorëzuar transaksionet bankare apo situacionet e pranimi lidhur me këto kontrata. Ne këtë rast OE ankues pretendon se këto transaksione bankare gjinden tek dokumenti 02. faqe 16 të cilën eksperti e ka kontrolluar dhe ka gjetur këtë letër dokument e lëshuar nga Banka Raiffeisen e cila letër tregon vërteton vetëm qarkullimin vjetor bankar të Operatorit dhe jo transaksionet e sakta apo transfere dhe pagesa të cilat vërtetojnë kontratën dhe liferimin e lartcekur. Pra këto dy dokumente dallojnë tërësisht nga ajo çka është kërkuar në Dosjen e Tenderit nga AK.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues NARA BIOTICS SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertit shqyrtues. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga OE ankues. Por është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues NARA BIOTICS SH.P.K., janë të pa bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar për shkak se dokumenti i paraqitur si kontratë nga ana e kompanisë ankuese NARA Biotics dhe MATKOS

Fharm ka shumë paqartësi ku në titull shkruhet që është kontratë pastaj brenda në tekst shkruan që është Reference e vlefshme nga 15.08.2021 deri me 30.04.2023 dhe me tutje një paragraf shkruan që kjo kontratë hyn në fuqi me datë 02.05.2023. Po ashtu Paneli Shqyrtues e mbështet konstatimin e ekspertit i cili vlerëson se OE ankues ka paraqitur vetëm qarkullimin vjetor bankar të Operatorit dhe jo transaksionet e sakta apo transfere dhe pagesa të cilat vërtetojnë kontratën dhe liferimin e lartcekur. Pra këto dy dokumente dallojnë tërësisht nga ajo çka është kërkuar në Dosjen e Tenderit nga AK. Bazuar në arsyet e lartcekura Paneli Shqyrtues ka konstatuar se AK ka vepruar konform dispozitave ligjore andaj vërteton Vendimin e Autoritetit Kontraktues - KOMUNA E GJAKOVËS, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material stomatologjik” me numër të prokurimit 632-23-8446-1-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Lidhur me tarifën është vendosur konform nenit 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - NARA BIOTICS SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: